

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVO - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRE NË DORËZIM PRIMLJENO RECEIVED			
Nr. org. Org. Jedinica Org. Unit	Nr. nrif. Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	351	22330	£



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA SUHAREKË
KONTRATË

KOMUNA SUHAREKË (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë, të cilën e përfaqson Mustafë Buzhala zyrtar i prokurimit dhe menaxheri i kontratës i caktuar me aktvendim nga ZKA në PMK dhe

Ermal Dinaj B.I., Pejë, -30000, Pejë- me Nr. NUI: 810756272 (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), të cilën e përfaqëson Ermal Dinaj në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për projektin:

Rregullimi i Kanalizimit në Bllacë dhe rregullimi i kanalizimit në Studenqan
Me nr te prokurimit 624-20-1681-5-2-1/624-20-020-5-2-1

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit "Rregullimi i Kanalizimit në Bllacë dhe rregullimi i kanalizimit në Studenqan", sipas specifikimeve teknike të dosjes së tenderit.
- 1.2 Punët duhet të përfundojnë sipas dinamikës së përcaktuar nga njësia e kërkesës, me se largu brenda 60 ditë pune dhe sipas dinamikës së përcaktuar nga menaxheri i projektit në PMK.
- 1.3 Operatori ekonomik para nënshkrimit të kontratës duhet të sjell sigurimin e ekzekutimit 10% të vlerës së kontratës për një periudhë prej: 90 ditësh.
- 1.4 E.O është i obliguar të bashkëpunojë me menagjerin e kontratës të Autoritetit Kontraktues dhe zyrën e prokurimit. OE është i obliguar të njoftoj zyrën e prokurimit dhe menagjerin e projektit, nëse projekti kapital nuk është duke u realizuar konformë kontratës dhe specifikimeve dhe paramanave të dhëna me kontratë.

Neni 2 Çmimi

- 2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 23.124,60 € (njëzetë e tremijë e njëqind e njëzetë e katër euro e gjashtëdhjetë cent).
- 2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.
- 2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.
- 2.4 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesën në euro, sipas faturave të dorëzuara së bashku me raportin e nënshkruar nga mbikëqyrësi dhe menaxheri i kontratës, në llogarinë bankare të OE.

Pagesa e fundit në vlerë jo më pak se 10 % vlerës së kontratës do të bëhet me raportin përfundimtar të nënshkruar nga mbikëqyrësi dhe menaxheri të projektit .

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) (Procesverbal i mbledhjes informative/vizitës se vendit)
- (g) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.



4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe¹ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.


4.5 Numri kontaktues i OE është **049 664-454**

ermaldinaj@gmail.com

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri:	Mustafë Buzhala
Pozita:	Zyrtar i zyrës së prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	11/06/2020
Vula	

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Ermal Dinaj
Pozita:	Përfaqësues
Nënshkrimi	
Data:	11/06/2020
Vula	

¹ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

PJESA III E KONTRATES **KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	Rregullimi i Kanalizimit në Bllacë dhe rregullimi i kanalizimit në Studenqan Me nr te prokurimit 624-20-1681-5-2-1/624-20-020-5-2-1
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës se kontratës me vlefshmëri prej 3 muaj .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për

		çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 3 ditë nga data e pranimit te kërkesës se Menaxherit te projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 3 dite pas nenshkrimit te kontrates, nese nuk specifikohet ndryshe ne PKM.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 60 ditë pune, ndërsa me PMK mundë të shkurtohet ky afat nëse palet pajtohen.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i kontratës i caktuar me aktvendim nga ZKA dhe në PMK .
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës se kontratës (me sigurim ekzekutimi).
Vërtetimet e pagesë	28	28.1 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit. 28.2. Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.
Shkaqet për	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 3 ditë.

kompensim		
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 365 ditë pas pranimi teknik.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	ZP Komuna Suhareke ose Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

Për:	ZYREN E PROKURIMIT KOMUNA SUHAREKË
Nga:	Ermal Dinaj B.I., Pejë, -30000, Pejë- me Nr. NUI: 810756272
Lënda:	DEKLERATË PER KUALITETIN E PUNIMEVE
Datë:	11/06/2020

I/e nderuar,

Rregullimi i Kanalizimit në Bllacë dhe rregullimi i kanalizimit në Studenqan
Me nr te prokurimit 624-20-1681-5-2-1/624-20-020-5-2-1

Për të përmbushur obligimet që dalin nga neni 27 pika 1 (KVK) e kontratës së lartcekur.

Ne konfirmojmë se:

Ne si Operator Ekonomik pas pranimit teknik ofrojmë garancion të rregullt 1 vjeçar, duke siguruar garancion prej 10 % nga vlera e kontratës, si dhe deklarojmë mbi cilësinë e punës dhe mallrave në kohëzgjatje 1 vjet nga dita e pranimit teknik dhe obligohemi dhe pranojmë se defektet e paraqitura gjatë afatit garantues do t'i sanojmë në kohën sa më të shkurtër dhe pa asnjë kompensim. Në të kundërtën ne pajtohemi se AK ato dëme do t'i sanojë me tjetër OE dhe të njëjtat shpenzime do të na faturojë ne si Kontraktor që kemi dhënë këtë deklaratë mbi garantimin e punëve.

Me respekt:

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit: Ermal Dinaj Nënshkrimi

DATA: 11/06/2020



ERMAL DINAJ

Paramasa dhe Paralogaria - Rregullimi i kanalizimit ne Blace dhe Rregullimi i kanalizimit në Studenqan					
Rregullimi i kanalizimit ne Blace					
Nr.	Përshkrimi i punëve dhe materialeve	Njësia	Sasia	Çmimi më TVSH për njësi-€	Shuma-€
1	Punët përgaditore				
1.1	Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve në projekt. Në çmim të llogaritet kosto e përpilimit të planit dhe programit punues si dhe e gjithë kosto e transportit dhe vendosjes së makinave dhe stafit punues si dhe akomodimi i përkohshëm i tyre	komplet	1.00	3,000.00	3,000.00
1.2	Fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizik i reperëve të rjetës shtetërore. Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i vijave ku do të kaloj rrjeti i kanalizimit fekal si dhe përcjellja e punimeve me instrument gjeodezik dhe sjella te AK e inqizimit gjeodezik sipas projektit te realizuar	m'	1,020.00	0.10	102.00
				Subtotali 1:	3,102.00
2	Punët Demoluese				
2.1	Demolimi i gypave të ndryshëm ngarkimi, transporti (maksimal 5 km prej punishtës) dhe shkarkimi i materialit të demoluar në deponinë legale ose në vendin te cilin e cakton Organi Mbikqyrës.	komplet	1.00	1,500.00	1,500.00
2.2	Demolimi i pusetave prej betoni dhe materialeve tjera si dhe ngarkimi, transporti (maksimal 5 km prej punishtës) dhe shkarkimi i materialit të demoluar në deponinë legale ose në vendin te cilin e cakton Organi Mbikqyrës.	komplet	1.00	1,500.00	1,500.00
				Subtotali 2:	3,000.00
3	Punët tokësore				
3.1	Pastrimi i trasesë nga muret, drujnët, shkurrët dhe pengesat tjera të cilat paraqitën për gjatë trasesë.	m'	1,020.00	0.05	51.00
3.2	Gërmimi i kanalit për kolektorët kryesor dhe sekondarë në kat. IV - V-të të dheut, më makinë dhe me dorë në gjërësi sipas normave dhe standardeve teknike (varësisht nga diametri i gypit) dhe thellësi sipas profilin gjatësor. Në këtë position përfshihet edhe sigurimi i kanalit nga shembjet e dheut sipas normave teknike per sigurimin ne pune.	m³	2,448.00	0.45	1,101.60
3.5	Ngarkimi dhe transporti i dheut të gërmuar (tepërt) deri në deponi te qytetit ose në vendin ku e cakton organi mbikqyrës në largesi maksimale deri në 5km.	m³	887.20	0.45	399.24
3.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës 0-16mm në fundin e kanalit anash dhe mbi gypa.	m³	387.20	3.00	1,161.60
3.7	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës 0-31.5mm për mbulim të kanalit në pjesët ku kalon nëpër rrugë traseja si dhe ngjeshja për rregullimin e rrugës.	m³	326.40	7.00	2,284.80
3.8	Mbulimi dhe planifikimi i kanalit me dhe te gërmuar dhe ngjeshja në shtresa 30cm deri në kuoten e terrenit.	m³	984.00	0.40	393.60
				Subtotali 3:	5,391.84
4	Punët montuese				
	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 për kolektorin kryesor si dhe planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ±1cm para vendosjes së gypit.				
4.2	PESN8 Ø250 mm	m'	492.00	4.00	1,968.00
4.3	PESN8 Ø200 mm	m'	288.00	3.00	864.00
4.4	PESN8 Ø160 mm	m'	240.00	3.00	720.00
				Subtotali 4:	3,552.00
5	Punët e betonit dhe armaturës				

5.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për pllakën e poshtme për puseta me betonarme C- 20/25, d=20cm.	m³	18.00	100.00	1,800.00
5.2	Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për kineta më përpunim sipas detalit.	m³	9.00	100.00	900.00
5.3	Furnizimi me material, transporti dhe montimi i tubave (për puseta) prej betonit të armuar Ø800/1000mm (elemente të parafabrikuara), konuseve për puseta prej betonit Ø800/700/600mm (elemente të parafabrikuara) si dhe montimi dhe betonimi i kurorës të kapakëve prej betoni t=12 cm për pusetat e kanalizimit. Thellësia mesatare e pusetave H=2.0 deri 3.0 m'. Paguhet për copë të pusetës së punuar me te gjitha elementet.	copë	11.00	35.00	385.00
5.4	Furnizimi me material, transporti dhe montimi i tubave (për puseta) prej betonit të armuar Ø800/1000mm (elemente të parafabrikuara), konuseve për puseta prej betonit Ø800/700/600mm (elemente të parafabrikuara), montimi i kapakëve prej Gize si dhe betonimi i kurorës C-20/25 per ankerim të kapakëve për pusetat e kanalizimit. Thellësia mesatare e pusetave H=2.0 deri 3.0 m'. Paguhet për copë të pusetës së punuar me te gjitha elementet.	copë	23.00	20.00	460.00
5.1	Furnizimi me material dhe lidhja e rrjeteve ekzistuese të kanalizimit në rrjetin ekzistues, me të gjitha punet percjellese deri ne fianlizim.	copë	4.00	10.00	40.00
Subtotali 5:					3,585.00

Rekapitullimi		
1	Punët përgaditore	3,102.00 €
2	Punët demoluese	3,000.00 €
3	Punët tokësore	5,391.84 €
4	Punët montuese	3,552.00 €
5	Punët e betonit dhe armaturës	3,585.00 €
Shuma e projektit:		18,630.84 €

Rregullimi i kanalizimit ne Studenqan					
Nr.	Përshkrimi i punëve dhe materialeve	Njësia	Sasia	Çmimi më TVSH për njësi-€	Shuma-€
1	Punët përgaditore				
1.1	Mobilizimi i ndërmarrjës për fillimin e punimeve në projekt. Në çmim të llogaritet kosto e përpilimit të planit dhe programit punues si dhe e gjithë kosto e transportit dhe vendosjes se makinave dhe stafit punues si dhe akomodimi i përkohshëm i tyre	komplet	1.00	20.00	20.00
1.2	Fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizik i reperëve të rrjetës shtetërore. Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i vijave ku do të kaloj rrjeti i kanalizimit fekal si dhe përcjellja e punimeve me instrument gjeodezik dhe sjella te AK e inqizimit gjeodezik sipas projektit te realizuar	m'	370.00	0.15	55.50
Subtotali 1:					75.50
2	Punët Demoluese				
2.1	Demolimi i gypave të ndryshëm ngarkimi, transporti (maksimal 5 km prej punishtës) dhe shkarkimi i materialit të demoluar në deponinë legale ose në vendin te cilin e cakton Organi Mbikqyrës.	komplet	1.00	10.00	10.00

5.4	Furnizimi me material, transporti dhe montimi i tubave (për puseta) prej betonit të armuar Ø800/1000mm (elemente të parafabrikuara), konuseve për puseta prej betonit Ø800/700/600mm (elemente të parafabrikuara), montimi i kapakëve prej Gize si dhe betonimi i kurores C-20/25 per ankerim të kapakëve për pusetat e kanalizimit. Thellësia mesatare e pusetave H=2.0 deri 3.0 m'. Paguhet për copë të pusetës së punuar me te gjitha elementet.	copë	9.00	15.00	135.00
5.1	Furnizimi me material dhe lidhja e rrjeteve ekzistuese të kanalizimit në rrjetin ekzistues, me të gjitha punet percjellese deri ne fianlizim.	copë	3.00	10.00	30.00
Subtotali 5:					1,075.00

Rekapitullimi		
1	Punët përgaditore	
2	Punët demoluese	75.50 €
3	Punët tokësore	20.00 €
4	Punët montuese	1,811.26 €
5	Punët e betonit dhe armaturës	1,512.00 €
Shuma e projektit:		4,493.76 €

Rekapitullimi		
1	Rregullimi i kanalizimit ne Bllace	18,630.84 €
2	Rregullimi i kanalizimit ne Studenqan	4,493.76 €
TOTALI:		23,124.60 €